

VENDIM
Nr. 3, datë 17.1.2019

**MBI REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË MTC ENERGY SHPK, PËR
VENDOSJE HIPOTEKE DHE BARRË MBI ASETET E SHOQËRISË “M.T.C.
ENERGY” SHPK, PËR EFEKT TË RISTRUKTURIMIT TË KREDISË NË FAVOR TË
RAFFEISEN BANK SHA**

Në mbështetje të neneve 16; nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; pikës 1.3 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 11 të “Rregullore të procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullave për organizimin funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.1.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut në lidhje me transferimin e aseteve të shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k., për lënie peng në favor të Raffeisen Bank, për efekt të ristrukturimit të kredisë, konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE në datën 26.12.2018 shoqëria “M.T.C Energy” sh.p.k., ka depozituar në ERE, kërkesën për vendosje hipoteke dhe barrë mbi asetet e shoqërisë “M.T.C. ENERGY” sh.p.k., për efekt të ristrukturimit të kredisë në favor të Raffeisen Bank sh.a. dhe me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 29 prot., datë 10.1.2019, ka përcjellë në ERE dokumentacion plotësues për aplikimin e tij. Po ashtu edhe Raiffeisen Bank sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 29/1 prot., datë 10.1.2019, ka përcjellë deklaratën nr. 614, datë 8.1.2019 dhe atë nr. 615, datë 8.1.2019, në funksion të këtij aplikimi.

- Kontrata e kredisë bankare nr. 4887 rep, nr. 2475 kol, datë 7.11.2016, që ndryshon kontratën nr. 4085 rep., nr. 1778 kol, datë 28.9.2012, e paraqitur nga subjekti në ERE, nuk parashikon barrësim apo lënie hipoteke të aseteve të të licencuarit, por vetëm ndryshimin e monedhës së përdorimit të linjës së kredisë dhe normës së interesit dhe dispozita të tjera që nuk shpreh për asetet e të licencuarit.

- ERE në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve fikse nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 119, datë 21.7.2016, të Bordit të ERE-s, shprehet vetëm për transferim të licencës ose të aseteve nga të licencuarit dhe jo për ristrukturim kredie (kolateral financiar). Si e tillë nuk është në kompetencën e ERE shqyrtimi i kërkesës së shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k., për vendosje hipoteke dhe barrë mbi asetet e shoqërisë “M.T.C ENERGY” sh.p.k., për efekt të ristrukturimit të kredisë në favor të Raffeisen Bank sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut do të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti